



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:237823

Datë: 26.04.2022

Numri i dokumentit: 02949480

**Pkr.nr.30/2022**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti për Krimet e Rënda** – kryetarja e trupit gjykues Ajser Skenderi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale kanosja në vazhdim nga neni 181 par.4 lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti për Krimet të Rënda PP/I.nr.258/2021 të datës 16.02.2022, në shqyrtimin e dytë publik të mbajtur më datën 15.04.2022, në prani të Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B.M. më datë 15.04.2022 shpalli, ndërsa me datë 26.04.2022 përpiloi me shkrim këtë:

### **AKTGJYKIM**

#### **I akuzuari:**

**E.B.** nga i ati A. dhe e ëma M. e lindur K. i lindur me datën .... në Prizren, ku edhe tani jeton, në rrugën .... student i vitit të parë në fakultetin UBT në Prizren, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal .... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

1.Me dt. 23.10.2021, rreth orës 20:00 minuta, pas marrëveshjes paraprake në mes veti fillimisht i pandehuri E.B. kontakton me të Dëmtuarit R.T. dhe I.B. në afërsi të stacionit të trenit në Prizren dhe u ofron atyre për tu shitur substancë narkotike të llojit marihuanë, pastaj furnizohen me substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, nisen në .... me dy automjete, njëri automjet Shkoda Oktavia, me targa .... të cilin e drejtonte i pandehuri E.B. dhe me automjetin VW Golf me ngjyrë të përhimët, me të cilën ishin duke udhëtuar të pandehurit A.D. dhe N.V. kur arrijnë në sheshin “Bahçelik” të .... i ndalin automjetet dhe i presin blerësit e marihuanës, rreth orës 20:05 minuta hasen nga policia, me ç’ rast policia nga ata sekuestron një qese me

mbishkrim “Gratis 2+1” me ngjyrë të kuqe në brendësinë e së cilës kishte substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, në peshë netto prej 246.79 gram, një qese najloni e mbështjellë me ngjitës me ngjyrë të zezë, me substancë të dyshuar për marihuanë, me peshë netto prej 43.27 gram, një qese najloni e mbështjellë me ngjitës me ngjyrë të zezë në brendësinë e së cilës kishte substancë të dyshuar për marihuanë, me peshë netto prej 12.45 gram, një qese najloni në brendësinë e të cilës kishte substancë e dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.76 gram, një qese najloni e cila ishte e mbushur me substancë të dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.89 gram dhe mbetje të substancës narkotike të dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.86 gram, të cilat të pandehurit i kanë poseduar pa lejen e organit kompetent (pesha e përgjithshme e substancës narkotike 305.02 gram), e i kishin përgatitur me qëllim që t’ia shesin blerësve nga Mamusha.

-Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

2. Deri me datën 23.10.2021, në Prizren në shtëpinë e tij, mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që gjatë një operacioni të Policisë së Kosovës në .... në pronësi të të pandehurit është gjetur një armë zjarri e llojit “Cal.9 mm P.A.K. Umarex-Lizenzfertigung Made in Germany, C55101378, Browning Mod. GPDA 9”, për të cilën nuk kishte leje për posedim.

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par. 1 i KPRK-së.

3.1. Me datën 21.10.2021, në Prizren, në afërsi të stacionit të trenit me përdorim të armës, seriozisht i kanoset personave të tjetër se do ta privojnë nga jeta, në atë mënyrë që në momentin kur të dëmtuarit R.T. dhe I.B. refuzojnë ta blejnë Marihuanën e ofruar i pandehuri i kërcënon me armën e përshkruar nën pikën 2.1 të dispozitivit, duke i kërkuar që t’ua blejë substancën narkotike të llojit marihuanë ose do ti vret, me ç’rast i shkakton atyre ankth dhe frikë për jetën e tyre.

3.2 Me datën 23.10.2021, në rrugën që lidh .... me fshatin .... me përdorim të armës, seriozisht i kanosin personit tjetër se do ta privojnë nga jeta, në atë mënyrë që në vendin kritik e takojnë të dëmtuarin R.T. dhe të njëjtin gjatë bisedës e kërcënojnë me armë, duke i kërkuar që t’ia kompensoj dëmin që nuk e ka blerë substancën narkotike të llojit marihuanë, me ç’rast i shkaktojnë të njëjtit ankth dhe frikë për jetën e tij.

- Me këtë, ka kryer veprën penale Kanosja në vazhdim nga neni 181 par. 4 e lidhur me nenin 77 parag.1 pika 1.1 e KPRK-së.

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 76, 79, në lidhur me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 31, 366 paragrafi 1 dhe 181 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 par. 1 pika 1.1 të KPRK, e

**G J Y K O N**

1. Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KP, me dënim me gjobë në shumën prej 500 euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.10.2021 deri më datën 15.04.2022 (5 muaj e 24 ditë).

2. Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KP me dënim me gjobë në shumën prej 700 euro.

3. Për veprën penale kanosja në vazhdim nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me nenin 77 par.1 pika 1. KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) Euro.

Konform nenit 76 paragrafi 2 nën par. 2.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumën prej 1700 euro të cilin dënim me gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve p as plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën gjykata mund t ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 20 euro gjobë do të llogaritetet barabartë me një ditë burgim.

Nga i akuzuari E.B. konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë të përgjithshme prej 305.02 gram, arma e zjarrit zjarri e llojit “Cal.9 mm P.A.K. Umarex-Lizenzfertigung Made in Germany, C55101378, Browning Mod. GPDA 9” si mjete të kryerjes së veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të njëjtat duhet të shkatërrohen.

Të akuzuarit E.B. pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i kthehet telefoni i markës “Iphone” me ngjyrë të zezë me numër të Sim kartelës 049-430-489.

Të dëmtuarit R.T. dhe I.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 150 euro si dhe 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, kësaj Gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.258/21 të datës 16.02.2022, kundër të akuzuarit E.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale kanosja në vazhdim nga neni 181 par.4 lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Në lidhje me këtë çështje, gjykata e ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 15.03.2022 në të cilin i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm. Ndërsa gjatë seancës së shqyrtimit të dytë i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit deklaroi se pasi që këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor për veprat penale për të cilat i vihen në barrë me aktakuzë dhe ka propozoj gjykatës që të njëjtit t ia shqiptojë dënimet e parapara me ligj si dhe dënimet plotësuese ashtu si janë të propozuara në aktakuzë, kështu i propozoj gjykatës që në kuptim të dispozitës së nenit 267 par.3 të KPRK, dhe nenit 284 të KPP, së bashku me aktgjykimin të lëshoj edhe urdhërin për konfiskimin e sendeve të përshkruara nën pikën 2.1 të propozimit të aktakuzës si dhe në kuptim të dispozitës së nenit 366 par.3 i KPRK ta bëjë konfiskimin e përhershëm të pistoletës kal.9 mm P.A.K Umarec- Lizenz Fertigung Made in Germany me nr. serik si në propozimin 2.2 të aktakuzës si dhe ti kthehet telefoni i markës “Iphone” me ngjyrë të zezë i dëmtuar në pjesën e pasme me futrolle me ngjyrë të zezë. Gjkata gjatë matjes së dënimit ti merr parasysh si rrethanë rënduese faktin e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale, faktin se në regjionin apo territorin e Gjykatës themelore në Prizren këto vepra penale janë në rritje e sipër dhe faktin se këto vepra penale apo me shpërndarjen e objektit të kësaj vepre penale afektohen të rinjtë, ndërsa si rrethanë lehtësuese le ta merr faktin e pranimit të fajësisë dhe moshën relativisht të re të këtu të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit deklaroi se në matjen e lartësisë dhe llojit të dënimit lidhur me të mbrojturin e tij ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese në këtë rast, veçanërisht faktin se në mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë e nëse analizohen edhe deklaratat në prokurori dhe polici qysh nga fillimi nuk ka shfaqur kurrfarë tendence që ti shmanget përgjegjësisë penale. Po ashtu si rrethanë lehtësuese në këtë rast konsiderojn se gjykata duhet ta merr faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale e edhe sot i mbrojturi i tij i ka veç 19 vjet. Pra, është i moshës së re dhe rrjedhimisht konsideron se edhe vet koha e kaluar nën masën e paraburgimit ka ndikuar mjaftueshëm në kuptimin e të njëjtit lidhur me rëndësin e veprimeve të tij, risocializimin dhe riedukimin e tij, po ashtu si rrethanë tjetër lehtësuese konsideron se duhet të merret edhe fakti se i mbrojturi i tij asnjëherë gjatë jetës së tij nuk ka kryer vepra penale të natyrës së njëjtë për të cilat edhe akuzohet nga ana e prokurorisë. Rrjedhimisht i njëjti nuk është recidivist, po ashtu si rrethanë tjetër lehtësuese konsideron faktin se duhet të merret gjendja e dobët ekonomike, si dhe fakti se i njëjti është edhe student. Andaj, kërkon nga gjykata që ti ketë parasysh këto rrethana si dhe rrethanat e tjera lehtësuese dhe ndaj të mbrojturit të tij të shqiptojë dënim sa më të butë nga se siç edhe vërehet i njëjti i ka kuptuar veprimet e veta, është penduar thellë dhe premtion se në të ardhmen do të përmbahet nga kryerja e çfarëdo veprimi i cili bie ndesh me ligjin.

I akuzuari është pajtuar me deklarimin e mbrojtësit.

Në bazë të lartëcekurave, e duke e marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, i cili pranim i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP-së, pasiqë i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, gjithashtu pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së pasi që Me dt. 23.10.2021, rreth orës 20:00 minuta, pas marrëveshjes paraprake në mes veti fillimisht i pandehuri Eni Bytyqi kontakton me të Dëmtuarit R.T. dhe I.B. në afërsi të stacionit të trenit në Prizren dhe u ofron atyre për tu shitur substancë narkotike të llojit marihuanë, pastaj furnizohen

me substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, nisen në .... me dy automjete, njëri automjet Shkoda Oktavia, me targa 04-525-BU, të cilin e drejtonte i pandehuri E.B. dhe me automjetin VW Golf me ngjyrë të përhimët, me të cilën ishin duke udhëtuar të pandehurit A.D. dhe N.V. kur arrijnë në sheshin “Bahçelik” të .... i ndalin automjetet dhe i presin blerësit e marihuanës, rreth orës 20:05 minuta hasen nga policia, me ç’ rast policia nga ata sekuestron një qese me mbishkrim “Gratis 2+1” me ngjyrë të kuqe në brendësinë e së cilës kishte substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, në peshë netto prej 246.79 gram, një qese najloni e mbështjellë me ngjitës me ngjyrë të zezë, me substancë të dyshuar për marihuanë, me peshë netto prej 43.27 gram, një qese najloni e mbështjellë me ngjitës me ngjyrë të zezë në brendësinë e së cilës kishte substancë të dyshuar për marihuanë, me peshë netto prej 12.45 gram, një qese najloni në brendësinë e të cilës kishte substancë e dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.76 gram, një qese najloni e cila ishte e mbushur me substancë të dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.89 gram dhe mbetje të substancës narkotike të dyshuar për marihuanë në peshë netto prej 0.86 gram, të cilat të pandehurit i kanë poseduar pa lejen e organit kompetent (pesha e përgjithshme e substancës narkotike 305.02 gram), e i kishin përgatitur me qëllim që t’ ia shesin blerësve nga Mamusha.

Poashtu në bazë të pranimit të fajësisë gjykata vërtetoi se i akuzuari është gajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së pasi që deri me datën 23.10.2021, në Prizren në shtëpinë e tij, mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që gjatë një operacioni të Policisë së Kosovës në .... në pronësi të të pandehurit është gjetur një armë zjarri e llojit “Cal.9 mm P.A.K. Umarex-Lizenzfertigung Made in Germany, C55101378, Browning Mod. GPDA 9”, për të cilën nuk kishte leje për posedim.

Poashtu në bazë të pranimit të fajësisë, u vërtetua se i akuzuari është fajtor edhe për veprën penale kanosja në vazhdim nga neni 181 par.4 lidhur me nenin 77 par.1 pika 1.1 të KPRK-së pasi që me datën 21.10.2021, në Prizren, në afërsi të stacionit të trenit me përdorim të armës, seriozisht i kanoset personave të tjetër se do ta privojnë nga jeta, në atë mënyrë që në momentin kur të dëmtuarit R.T. dhe I.B. refuzojnë ta blejnë Marihuanën e ofruar i pandehuri i kërcënon me armën e përshkruar nën pikën 2.1 të dispozitivit, duke i kërkuar që t’ua blejë substancën narkotike të llojit marihuanë ose do ti vret, me ç’ rast i shkakton atyre ankth dhe frikë për jetën e tyre dhe me datën 23.10.2021, në rrugën që lidh .... me fshatin .... me përdorim të armës, seriozisht i kanosin personit tjetër se do ta privojnë nga jeta, në atë mënyrë që në vendin kritik e takojnë të dëmtuarin R.T. dhe të njëjtin gjatë bisedës e kërcënojnë me armë, duke i kërkuar që t’ia kompensoj dëmin që nuk e ka blerë substancën narkotike të llojit marihuanë, me ç’ rast i shkaktojnë të njëjtit ankth dhe frikë për jetën e tij, për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasiqë paraprakisht vërtetoi se i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë dhe motivet nga të cilat është kryer vepra penale dhe si rrethanë lehtësuese morri parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, zotimin se në të ardhmen vepra të këtilla nuk do të kryej, gjendjen e tij materiale financiare, faktin se nuk ka qenë i dënuar më herët, pasiqë në shkresat e lëndës nuk kemi ndonjë provë –aktgjykimin të plotëfuqishëm se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më herët për ndonjë vepër penale. Pasiqë rrethana rënduese nuk gjeti gjykata është e mendimit se dënimi i këtu i shqiptuar si në dispozitiv është

në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se me këtë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit, t'i mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata vendosi për këtë lloj të dënimit pasi që krijoi bindjen se i akuzuari në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tjera penale dhe se është mendimi i gjykatës se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjesisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe që të përmbahet, nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në kuptim të nenit 267 par.5 dhe 366 par.3 të KPRK-së pasi që i akuzuari u gjet fajtor për veprat penale sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe u vërtetua se sendet e njëjta janë mjete të kryerjes së veprës penale dhe kanë mundësuar edhe kryerjes e veprave penale.

Vendimi për kthimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 116 par. 1 të KPP-së pasi që nuk ka bazë për konfiskimin e këtij sendi.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë konform nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par. 1 të KPP-së dhe vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2021:237823, 22.04.2022**

B. Profesional  
Shqipron Sedolli

**Kryetarja e trupit gjykues  
Ajsër Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykata.